

MUZA POETIKE E DIASPORËS

Infinitet poetike të Gjekë Marinajt

(Rreth librit me poezi "Infinit" të autorit Gjekë Marinaj)

Kuajt

Tërë jetën duke vrapuar rrimë
Shohim veç përpara
Ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë.
Ne nuk kemi emër
Të gjithëve kuaj na thonë.
Nuk qajmë,
Nuk qeshim;
Heshtim,
Dëgjojmë;
Hamë atë ç'na japin,
Ecim nga na thonë,
Asnjë nga ne s'është mendje hollë.
Kush qe kalë mbreti,
Posti qe i lartë
Kush qe kalë princeshe
I bënë shalë të artë
Kush qe kalë fshatari
Pat samarë me kashtë
Kush qe kalë i egër
Tërë jetën fjeti jashtë.
Po qemë dhe mbetëm kuaj, para njeriut!

Ana tjetër e rebelimit

Mos të kthehem tek britma e ëndrrës së mbrëmshme,
Apo tek durimi i shkrirë në të bardhën e syve, njerëz.
Le t'i lëmë djegiet e brendshme të avullojnë të luhatura...

Ngadalësoi gjurmët drejtë varrezave të ndjenjave, njeri.
Dua të vuaj me ty!
Por qelqen e qytetit të nëndheshëm dëshiroj ta thej.

Brinjët e së sotmes s'duhet të mbetën skeleti i së nesërmes.
Fundi dhe fillimi i jetës s'duhet të çikin njëri-tjetrin.

Shoqet e zyrës sime

Ato hyjnë në zyrë si boja e freskët në varg.

Takohem me të gjitha si me puhizën e mëngjesit:
Sytë e ditës mbushen me aromën e tyre njerëzore.

Ndërsa unë, që s'e imagjinoj Akilin të ketë pasë thembra,
Pa e kuptuar kërkoj nënshtetësi tek atdheu i tyre i bukurisë.

Në vargun e gjatë të poetëve që jetojnë larg Atdheut është edhe poeti Gjekë Marinaj i cili viteve '90 në gazetën "Drita" të Tiranës do botojë një poezi me titull "Kuajt", të cilën sigurimi i atëhershëm do ta lexonte si fyerje dhe kjo do t'i mjaftonte për të filluar përndjekjet ndaj këtij krijuesi të ri, i cili më vonë do jetë i shtrënguar për t'u arratisur.

Duke pasur një udhë të vështirë Marinaj vetëportretohet si poet me një talent të veçantë, poezia e të cilit në rrafshin tematik preokupohet me tema të shumta dhe nga më të ndryshmet të cilat tek Marinaj janë të ngulitura që nga fëmijëria e tij e hershme plot trishtim nën një diktaturë si ajo nëpër të cilën kaloi Shqipëria, tek një hark tjetër tematik për Kosovën dhe rreth saj, tema me subjekt të caktuar mediativ-filozofik e deri tek ato që lidhen me Amerikën, këtë vend të bukur e të ëndrruar nga njerz të shumtë anë e kënd botës, vend ky në të cilin tani e disa vjet Marinaj bën jetë mërgimtari.

Poezitet e Marinajt shquhen për një dendësi të rrallë figurash, të cilat bashkëjetojnë në harmoni të qëndrueshme dhe funksionale, apo: "E organizuar nga principe të fshehta ritmesh, dhe disa herë me varg të lirë, verlibër, kjo poezi të jep ndjesinë e shqetësimit estetik... arrin shpesh një nginjje të begatë figurative, diç që të ndërmend figuracionin barok..." do të shprehet redaktori Agron Tufa në parathënien e librit të dytë të Gjekë Marinajt "Infinit" të botuar në vitin 2000.

Tek poezia e Marinajt hasim një lirizëm meditativ, shpesh gjejmë edhe idilikën por edhe një lirizëm të theksuar social siç është ai me temë për të pastrehët amerikanë, për meksikanët, për vajzat arabe, tema këto të cilat Marinaj i shpjegon me një nivel të lartë artistik:



Ballina e librit "Infinit"

Ata shtyhen si flamë e keqe pylli
Mbështjellë si myk
Në dosje të qullura mëkatesh.
Poezia "Dhembjet e tyre kanë çelur sythe"

Gjekë Marinaj në vitin 1995 ka botuar librin e tij të parë "Mos më ik larg" dhe poezia e tij ka paralajmëruar për një poet të spikatur, nga më të spikaturit të gjeneratës së re.

Marinaj i lindur në rrethinën e Shkodrës tani e më shumë se dhjetë vjet jeton dhe punon në Amerikën e largët, shkruan kryesisht poezi.

Përgatiti: Bujar Salihu**MË 12 MAJ NË HESLEHOLM TË SUEDISË**

Festival i këngës shqipe dhe suedeze për fëmijë

Ditën e diele, më 12 maj, duke filluar prej orës 11.00 në Hesleholm të Suedisë do të mbahet festivali i parë i muzikës për fëmijë në gjuhën shqipe dhe suedeze. Deri më sot, pjesëmarrjen e kanë konfirmuar 130 fëmijë të mërgimtarëve tanë dhe 100 fëmijë suedeze. Vlen të përmendet se interesimi për këtë festival është shumë i madh, jo vetëm në mesin e shqiptarëve por edhe ndër suedezët. Përgatitjet e duhura në kuadër të Bashkësisë së Shoqatave i bëri Shoqata "Alba" në bashkëpunim me shoqatën shqiptaro-suedeze. Një ekip i Radio Televizionit të Kosovës do ta përcjellë rrjedhën e festivalit dhe do të kryejë incizime nga ky festival.

I.E

TË DIELEN NË CYRIH

Mbahen Takimet Poetike Pranverore të Diasporës

Këtë të dielë, më 12 maj, duke filluar në orën 15.00 në Volkshaus, (Salla e verdhë) Klubi Letrar "Faik Konica" i Cyrihut, në dhjetëvjetorin e themelimit organizon manifestimin "Takimet Poetike Pranverore të Diasporës". Në kuadër të tij do të mbahet edhe ora e madhe Patrara ku do të ndahet çmimi "Pena e artë" për poezinë më të mirë të lexuar. Krahas

kësaj do të ketë edhe pika muzikore dhe do të ndahet çmimi "Azem Shkreli" për librin më të mirë të botuar nga autorë të diasporës. Do të kumtohen po ashtu çmimet për konkursin e shpallur kohë më parë nga ky klub për gjininë e poezisë, prozës dhe eseut. Do të mbahet edhe tribuna me temën "Atdheu në poezinë e poetëve të mërgimit".

INFORMATIKA GJITHNJË E MË E KËRKUAR NË ÇDO FAMILJE SHQIPTARE TË DIASPORËS;

Familjet shqiptare në Zvicër dhe kompjuterizimi

Krahas zhvillimit të shkencës së informatikës në sektorin privat, i cili ka bërë që pothuaj çdo familje zvicerane të ketë një kompjuter personal, edhe familjet shqiptare me qëndrim në Zvicër nga dita në ditë kanë shtuar interesimin për të pasur një kompjuter në shtëpi, jo vetëm si kërkesë profesionale por tashmë edhe domosdoshmëri jetësore. Dihet, thotë pronari i zyrës së informatikës z. Gjini se në Basel jetojnë rreth 12 mijë shqiptarë, të cilët me ndryshimin e kohëve kanë ndryshuar edhe vetë në shumë çështje; sepse tani dhe gjatë viteve të fundit shqiptarët nuk i kemi vetëm puntorë të thjeshtë si dikur, por numri i bashkatdhetarëve punëtorë dhe të tjerë, të cilët i kanë sjellur familjet e tyre dhe që janë integruar në Zvicër, (proces i cili po vazhdon), është i madh. Prandaj, numri i nxënësve shqiptarë të cilët shkollohen në Zvicër në të gjitha lëmitë është i madh, të cilët përgatitën për një profesion për të ardhmën. Në këtë aspekt duke qenë e ditur se në sistemin e shkollimit zviceran informatika ka një shkallë të lartë në çdo fushë, pa njohjen e kompjuterit është shumë e vështirë për të

Në zyrën e informatikës në Basel "Cini computer Shop" klientëve u ofrohen shumë shërbime në fushën e informatikës; përveç kompjuterëve dhe programeve të shumta, këtu ju presin edhe shërbime të instalimit dhe programimit të kompjuterit. Pronari z. Gjini dhe punonjësi z. Idriz Salihu flasin për kërkesa të shumta gjatë punës së tyre të përditshme me klientët, në mesin e të cilëve ka gjithnjë e më shumë edhe shqiptarë.

pasur sukses të plotë në shumë fusha të procesit shkollor dhe pastaj edhe shumë më vështirë për të siguruar një vend të punës në të ardhmen. Për këtë qëllim, duke kuptuar këtë rëndësi interesimi i familjeve shqiptare po rritet çdo ditë që në kërkesë të plotësimit të kushteve të fëmijëve të tyre ta kenë edhe një kompjuter. Kështu punonjësi pranë kësaj qendre shitëse z. Idriz Salihu thotë se përveç klientëve zviceranë kërkesat më të shumta të klientit shqiptarë janë përveç instalimit të programeve të ndryshme, sidomos për instalimin e internetit dhe E-mail-it. Kam vërejtur thotë Idrizi se shumë nga bashkatdhetarët tanë shpesh nga bashkatdhetarët tanë pavarësisht nga profesioni i tyre dhe puna që bëjnë, ata kanë dëshirë të futën në internet dhe

të shfrytzojnë informata nga mediat e vendlindjes. Ndërkaq, kur klientëve iu sqaroi disa nga mundësitë e punës edhe për regjistrimin dhe përpunimin e shumë të dhënave të familjes, atëherë interesimi i tyre bëhet edhe më i madh. Shumë nga ata që blejnë kompjuter nuk kryejnë asnjë kurs, dhe nga mos njohja shpesh bëjnë gabime të cilat shkaktojnë çrregullime të instalimit të programeve etj., etj.

Ajo çfarë është më rëndësishme shprehen këta dy punonës të shitorës shitëse të informatikës "Gini Com. Shop" në Bazel, se numri i të interesuarëve nga bashkatdhetarët tanë për të pasur një kompjuter në familje po rritet nga dita në ditë dhe ky fakt na gëzon shumë.

S. Sadiku